

RAPORT PËRMBYLLËS I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE BANKERS PETROLEUM-01/PATOS, SHQIPËRI

Nëntor 2018

Ky raport paraqet një përmbledhje të procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO-s dhe rezultatet e tij në lidhje me ankesën Bankers Petroleum-01/Patos.

HYRJJE

Projekti i IFC-së

IFC ka patur një projekt aktiv me një Bankers Petroleum Ltd. (Bankers ose kompania), një kompani naftë dhe gazit me qendër në Kanada, e fokusuar ekskluzivisht në kërkimin dhe prodhimin e naftës në Shqipëri. Investimi i IFC-së në projekt përfshinte një kredi A, me vlerë 55 milionë USD dhe 10 milionë USD në kapital për të ndihmuar zhvillimin financiar të aseteve të kompanisë në Shqipëri.

Në vitin 2016, Bankers u ble nga një degë e Korporatës së Naftës Geo-Jade, një kompani ndërkombëtare për kërkim dhe prodhim të naftës dhe gazit. Megjithëse Geo-Jade e rimbursoi kredinë tek IFC-ja, kompania konfirmoi vullnetin e saj për të vazhduar përfshirjen në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lehtësuara nga CAO, i cili ishte në vazhdim në atë kohë.

Ankesa

Në mars 2013, CAO mori një ankesë nga një ambientalist me qendër në Tiranë, në emër të banorëve që jetojnë në aftësi të fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës. Ankuesi, i cili mbështej nga banorë të Zharrzës, pretendonte se operacionet e kompanisë kishin shkaktuar impakte negative në shëndet, aksidente, ndotje të rrjetit të vaditjes dhe lëkundje sizmike, që u kishin dëmtuar shtëpitë dhe ndërtesat. Në përgjithësi, ankuesit ishin të shqetësuar për ndikimin që kishte nxjerrja e naftës dhe gazit në zonën e tyre, dhe për rreziqet dhe dëmet e mundshme për komunitetin dhe mjedisin.

Vlerësimi nga CAO

Ankesa i plotësonte kushtet e pranueshmërisë të CAO-s dhe në maj 2013 u bë vlerësimi i

ankesës. Në vijim të vlerësimit nga CAO, palët – anëtarë të komunitetit nga Patos-Marinza dhe përfaqësues nga kompania – ranë dakord të përfshihen në një proces dialogu të lehtësuara nga CAO për të eksploruar mundësi për një proces hulumtues të përbashkët që kishte për qëllim adresimin e shqetësimeve në lidhje me aktivitetin sizmik në afërsi të Zharrzës, si dhe çështje të tjera sociale dhe mjedisore me një spektër më të gjerë në zonat përreth fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës.

PËRGATITJA PËR PROCESIN E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

Qartësimi i çështjeve dhe konfirmimi i vullnetit të palëve për t'u përfshirë në dialog

Procesi i vlerësimit u pasua nga një mision parapërgatitor në tetor 2013 për të rishikuar gjetjet nga procesi i vlerësimit, për të mbledhur inpute dhe ide për të propozuar një proces hulumtues të përbashkët, dhe për të arritur konsensusin për hapat e mëtejshëm. Grupi i CAO-s u takua me palë të ndryshme të interesit, duke përfshirë ankues, banorë nga Zharrza të cilët kishin mbështetur ankesën drejtuar CAO-s, përfaqësues nga Bankers dhe nga pushteti vendor dhe qendror.

Një takim i përbashkët, ku morën pjesë anëtarë të komunitetit, përfaqësues të kompanisë, dhe përfaqësues nga pushteti vendor e qendror u organizua në janar 2014. Pas atij takimi, për CAO-n nuk ishte e qartë nëse të gjithë ata që morën pjesë ishin mbështetës së idesë për t'u përfshirë në një proces dialogu. Gjithashtu, nuk ishte e qartë se në ç'masë përfaqësonin pjesëmarrësit në takimin e janarit interesat më të gjëra të

komuniteteve të tyre përkatëse. Prandaj, u ra dakord nga palët, që CAO të takohej veç e veç me grupe të komunitetit dhe përfaqësues të Bankers për t'u njohur me këndvështrimet dhe propozimet e tyre në lidhje me vazhdimin e procesit të dialogut. Në prill 2014 CAO zhvilloi takime bilaterale me palët për t'i qartësuar këto pyetje dhe çështjet që do të adresohen përmes dialogut, dhe për të rishqyrtuar çështjen e përfaqësimit në grupin e dialogut. Qëllimi ishte të arrihej në një përdundim të përbashkët, që të pranohej nga të gjithë pjesëmarrësit, për atë se si një proces i tillë mund të ndihmonte për identifikimin dhe arrijtjen e qëllimeve të tyre të përbashkëta.

Rritja e kapaciteteve

Para fillimit të përfshirjes së palëve në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, CAO punoi ngushtë me komunitetin dhe drejtuesit lokalë për të identifikuar njerëz nga fusha të ndryshme për të marrë pjesë në proces. Pasi identifikimit të tyre, CAO organizoi një workshop për rritjen e kapaciteteve për përfaqësuesit e komunitetit për t'i ndihmuar ata të kuptonin më mirë teknikat për një komunikim efektiv, negocimin dhe parimet e ndërmjetësimit. Workshopi i parë u organizua në korrik 2014. Ky workshop u fokusua gjithashtu në përgatitjen e një draft strukture për dialogun.



Workshop për rritjen e kapaciteteve me anëtarë të komunitetit, Korrik 2014

Workshopet për rritjen e kapaciteteve kishin si qëllim të ndihmonin anëtarët e tryezës së rrumbullakët të zgjerimin njohurisë dhe aftësitë për të qenë më efektiv dhe bashkëpunues në procesin e dialogut, dhe që të ishin të informuar si për procesin, dhe për rezultatet e tij, që do t'i ndihmonte në marrjen e vendimeve përkatëse.

Kjo qasje e rritjes së kapaciteteve u përsërit për anëtarët e rinj (si për përfaqësuesit e komunitetit dhe të kompanisë) të cilët iu bashkuan grupit të dialogut me vonë gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (shkurt 2015, tetor 2015 dhe korrik 2017).

Parimet dhe rregullat bazë

Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve filloi zyrtarisht në dhjetor 2014. Në një takim të përbashkët, palët diskutuan dhe ranë dakord për qëllimin e përgjithshëm dhe objektivat e procesit, rezultatet e pritshme, kornizën e dialogut dhe çështjet që do të adresoheshin përmes dialogut.

Palët ranë dakord që procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të synonte: vendosjen e dialogut konstruktiv, shkëmbimin e informacionit, identifikimin e mënyrave për përmirësimin e situatës, përmirësimin e kanaleve të komunikimit, ndërtimin e besimit midis komunitetit dhe kompanisë dhe ndërtimin e një procesi bashkëpunues afatgjatë për të adresuar shqetësimet sociale dhe mjedisore në lidhje me projektin.



Tryeza komunitet-kompani në të cilën palët ranë dakord për rregullat bazë të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, Dhjetor 2014

Strukturimi i procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Në bashkëpunim me palët, u strukturua procesi i dialogut si më poshtë:

- Krijimi i një tryeze të rrumbullakët të përbërë nga të gjithë përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanisë.
- Tre grupe pune të përbërë nga anëtarë të caktuar të tryezës së rrumbullakët,

ku secili grupi u ngarkua të trajtonte çështjet që iu përkisnin kategorive të mëposhtme:

- tërmetet;
- mjedisi; dhe
- investimet dhe çështjet sociale.



PROCESI I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

Në janar 2015, grupet e punës filluan të takohen çdo muaj për të identifikuar dhe diskutuar çështjet specifike sipas tematikës së grupit. Në gjashtë muajt e parë të takimeve të grupeve të punës, pjesëmarrësit u fokusuan në shkëmbimin e informacionit dhe për të mësuar më shumë për çështjet, shqetësimet dhe/ose standardet rregullatorë sipas tematikave kryesore të identifikuara. Tryeza e Dialogut, ku përfshiheshin të gjitha grupet e punës, mbledheshin në mënyrë periodike për të diskutuar për progresin e bërë dhe hapat e mëtejshëm.

Në fazën e dytë të procesit, e cila filloi në korrik 2015, grupet e punës identifikuan çështjet kryesore për t'u negociuar, si dhe strategjitë për zbatimin e zgjidhjeve praktike dhe planeve të punës për të adresuar këto çështje. Si rezultat i këtij procesi, palët identifikuan 33 çështje që lidhen me: tërmetet (8 çështje), mjedisin (9 çështje) dhe investimet dhe çështjet sociale (16 çështje). Më vonë, Grupi i Punës për Tërmetet dhe ai i Mjedisit u bashkuan në një grup për të shmangur mbivendosjen e përpjekjeve dhe për të ofruar një proces më efikas. Palët gjithashtu vendosën se disa çështje duhet të hiqeshin nga axhenda e negociimit, pasi ose nuk kishin lidhje, ose përfshinin aktorë të tjerë.

Gjatë procesit të dialogut, grupi i ndërmjetësve organizoi dhe moderoi një sërë takimesh bilaterale me palët dhe aktorë të tjerë (sipas nevojës), takime të grupeve të punës, dhe takime të Tryezës së Rrumbullakët të Grupit të Dialogut. Procesi u mundësoi anëtarëve të tryezës që të rrisnin besimin dhe të eksploronin dhe diskutonin opsione që do t'i adresonin çështjet në mënyrë që të dyja palët të ishin të kënaqura.

REZULTATE

1) Tërmetet/Lëkundjet

Blerja dhe instalimi i dy sizmometrave në zonën e Patos-Marinzës

Në përgjigje të drejtpërdrejtë të shqetësimeve të komunitetit, Bankers, në konsultim me Institutin e Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), bleu dy sizmometra për të mundësuar përmirësimin e monitorimit kombëtar sizmologjik si dhe për të pasur një rezolucion më të qartë për zonën e Patos-Marinzës. Sizmometrat u instaluan në vendet e përcaktuar nga ekspertët përkatës.



Një nga dy sizmometrat e instaluar në zonën e Patos-Marinzës

Lidhja e sizmometrave me rrjetin kombëtar sizmologjik

Instalimi teknik i sizmometrave në terren u përfundua në shkurt 2014, dhe lidhja e tyre me rrjetin kombëtar u realizua në shtator 2016. Bankers dhe institucionet shtetërore përkatëse firmosën një marrëveshje për monitorimin dhe mirëmbajtjen e sizmometrave, në vijim të përpjekjeve të pjesëmarrësve në procesin e dialogut të lehtësuar nga CAO. Këto përpjekje

përfshinin kërkesa të përbashkëta drejtuar zyrtarëve shtetërore në emër të grupit të dialogut, duke kërkuar informacion në lidhje me vënien në punë të sizmometrave dhe transferimin e të dhënave sizmike nga dy sizmometrat në rrjetin kombëtar, si dhe duke i ftuar përfaqësuesit nga institucionet përkatëse të merrnin pjesë në takimet e grupit për t'i informuar në lidhje me procesin e instalimit dhe të lidhjes së sizmometrave. Të dhënat e marra nga sizmometrat tashmë merren nga IGJEUM dhe do të përdoren si informacion për studime për të kuptuar më mirë shkaqet e tërmeteve/lëkundjeve në zonë.

Studimi mbi aktivitetin sizmik

Grupi i Dialogut ra dakord për kryerjen e një studimi në lidhje me historikun dhe trendin e lëkundjeve në terren, i cili u krye nga Universiteti "Aristoteli" i Selanikut.

Studimi synonte të paraqiste një tablo më të qartë të ndryshimeve kohore të aktivitetit sizmik në Shqipëri gjatë 50 viteve të fundit dhe të shqyrtonte ngjarjet sizmike në zonën e Patos-Marinzës për të njëjtën periudhë kohore.

Qëllimi i studimit ishte të përcaktohej nëse kishte pasur ndonjë anomali në aktivitetin sizmik dhe të shikonte për ndonjë lidhje ndërmjet operacioneve të kompanisë dhe lëkundjeve që ndodhin në zonë.

Studimi doli në përfundimin se "të dhënat që u konsideruan në një rreze kërkimi (15 dhe 24km) zbuluan luhajtje të rastësishme të normës së sizmicitetit (tipike për aktivitetin sizmik) pa ndonjë korrelacion (pozitiv apo negativ) me shkallën e shfrytëzimit të fushës naftëmbajtëse".

Gjetjet e raportit u prezantuan për grupin e dialogut dhe iu dërguan institucioneve shtetërore përkatëse. Duke qenë se studimi ishte teknik dhe gjetjet nuk ishin lehtësisht të perceptueshme për pjesëmarrësit e grupit të dialogut, grupi kërkoi interpretim nga institucionet qeveritare dhe IGJEUM. Në janar 2017, qeveria vendosi të bënte një studim të mëtejshëm të pavarur në lidhje me shkaqet e tërmeteve në zonën e Patos-Marinzës.

Marrëveshja për t'u mbështetur te procesi i qeverisë në lidhje me çështjen e tërmeteve

Megjithëse studimi në lidhje me çështjen e tërmeteve u krye me dakortësi të grupit të dialogut, anëtarët e komunitetit dhe kompania ende kishin pikëpamje të ndryshme në lidhje me shkaqet e tërmeteve/lëkundjeve në zonë.

Në tetor 2017, palët ranë dakord që, në vend që të merrnin pjesë në një proces të drejtuar nga CAO për të eksploruar për çështjen e tërmeteve, ata do të mbështeteshin te procesi kërkimor i pavarur, që po ndërmernte qeveria paralelisht lidhur me shkaqet e tërmeteve. Tryeza e grupit të dialogut, e cila do të vazhdojë të mbledhet edhe pas mbylljes së procesit të CAO-s, do të kërkojë informacion nga qeveria lidhur me rezultatet e studimit të pavarur.

2) Çështjet e mjedisit

Në lidhje me çështjet e mjedisit, procesi i dialogut ndihmoi në njohjen dhe kuptimin më të mirë të veprimtarisë së kompanisë dhe programeve të saj të monitorimit mjedisor. Rezultatet rreth çështjeve mjedisore janë arritur përmes:

Shkëmbimit të informacionit

Janë organizuar takime të veçanta për t'i ndihmuar anëtarët e komunitetit të njihen me programet e monitorimit të mjedisit, për t'i informuar për standardet ndërkombëtare dhe kombëtare që ndjek kompania, dhe për t'u demonstruar pajisjet e përdorura për kontrollin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës.

Gjatë periudhës 2015-2017 u kryen tri vizita në terren për t'u dhënë një mundësi grupeve nga komuniteti të shikonin investimet e bëra nga kompania. Këto investime lidheshin me përmirësimet teknologjike dhe të cilësisë së ajrit, instalimin e sizmometrave dhe impiantët e trajtimit të mbetjeve.



Palët duke u përgatitur për në vizitë në terren te operacionet e kompanisë, Nëntor 2015

Monitorimi me pjesëmarrje

Në tremujorin e parë të vitit 2016, një grup prej shtatë anëtarësh nga komuniteti, ku u përfshinë pjesëmarrës nga grupi i dialogut, një specialist mjedisi dhe disa studentë, u bënë pjesë e një programi monitorues me pjesëmarrje (të përbashkët). Ata ndoqën një trajnim mbi monitorimin mjedisor, ndoqën në terren grupin e monitorimit të kompanisë, dhe u ftuan të njiheshin me disa nga rezultatet e aktiviteteve të monitorimit mjedisor të kompanisë.

“Procesi i krijoj hapësirë kompanisë për t’u treguar dhe për t’i ndihmuar anëtarët e komunitetit të kuptonin më mirë operacionet e saj, dhe masat e ndërmarra tashmë për të adresuar çështjet sociale dhe mjedisore që lidhen me projektin”

Reflektim nga një përfaqësues i kompanisë në një takim të tryezës së dialogut, Shtator 2018

Në vijim të monitorimit me pjesëmarrje, anëtarët e komunitetit që ishin pjesë e programit, ndanë përvojën e tyre me grupin e dialogut dhe shprehën vlerësim për masat e marra nga kompania për të monitoruar dhe përmirësuar mjedisin.

“Ne duhet të kishim marrë një ‘diplomë universiteti’ duke marrë parasysh gjithë njohuritë dhe informacionin që kemi marrë.”

Reflektim i shprehur nga një anëtar i komunitetit në një nga tryezat e dialogut ku diskutohej progresi dhe hapat e mëtejshëm

Investimet për të përmirësuar mjedisin dhe cilësinë e ajrit

Megjithëse investimet për përmirësimin e mjedisit nuk ishin rezultat i drejtpërdrejtë i procesit të dialogut, shqetësimet lidhur me çështjet mjedisore dhe cilësinë e ajrit të shprehura nga anëtarët e komunitetit gjatë diskutimeve me kompaninë, ndihmuan në përshtetimin e zbatimit të këtyre projekteve.

Gjatë gjithë procesit, kompania vazhdimisht informoi grupin e dialogut mbi ecurinë e këtyre projekteve, ku përfshihen:

- Instalimi i tubacionit të naftës;
- Kapja e gazit/njësitë për përpunimin e avujve;
- Elektrifikimi i makinerive - pjesa më e madhe e motorëve tani punojnë me energji elektrike dhe jo naftë, e cila i ul çlirimet në atmosferë dhe minimizon djegien e gazit;
- Projekti i shuarjes së pluhurit në rrugë – projekt i zbatuar në 2014 dhe 2016, ku përfshihen spërkatja e rrugëve dhe përdorimi i përbërësve për shuarjen e pluhurit dhe reduktimi i përdorimit të kamionëve;
- Rehabilitimi i vazhdueshëm i mjedisit;
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe i mbetjeve; dhe
- Monitorimi i vazhdueshëm (i kryer çdo tremujor) i ujit të nëntokës, prodhimi dhe trajtimi i mbetjeve, çlirimet në atmosferë, trajtimi i ujërave të zeza, uji në sipërfaqe, materialet për ripërdorim, cilësia e ujit, etj.



Tubacionet e transportimit të naftës, gazit dhe ujit, të ndërtuar për të ulur trafikun, në zonën qendrore të nxjerrjes në Patos-Marinëz (Foto nga: Felix Davey).

3) Çështjet sociale dhe të investimeve

Shkëmbimi i informacionit

Gjatë gjashtë muajve të parë të procesit të dialogut, palët u përqendruan në shkëmbimin e informacionit, si për çështjet e mjedisit, ashtu edhe për çështjet sociale dhe të investimeve. Këto të fundit përfshinin: çështjet e burimeve njerëzore (programi i praktikës për studentët, trajnimi profesional, politikat dhe praktikat e punësimit); taksat e paguara nga kompania; dhe projektet e mbështetura nga kompania.

Anketimi mbi prioritetet e investimeve

Në tetor-nëntor 2015 u krye një anketim për të parë perceptimet e banorëve të zonës së Patos-Marinzës dhe për të kuptuar më mirë preferencat dhe përparësitë e tyre në lidhje me investimet. Anketimi shërbeu për të orientuar më mirë dhe për të përmirësuar programin e kompanisë për investimet në komunitet në atë zonë. Drafti i pyetësorit, si dhe rezultatet e anketimit u prezantuan për tryezën e dialogut.

E njëjta procedurë u ndoq dhe në vitin 2018 për të anketuar komunitetin. Sugjerimet nga grupi i dialogut në lidhje me metodologjinë u morën parasysh nga shoqata e komunitetit e cila kreu anketimin.

“Megjithëse kompania ka bërë investime në komunitet edhe para ankesës, procesi i dialogut na tregoi se ka mënyra të ndryshme angazhimi me komunitetin dhe na ndihmoi të kuptonim më mirë çështjet që ishin të rëndësishme për ta.”

Reflektim i shprehur nga një përfaqësues i kompanisë në një takim të tryezës së dialogut në shtator 2018

Projekti i mbjelljes së pemëve

Një pikë e ngritur vazhdimisht në diskutimet midis komunitetit dhe kompanisë ishte çështja e gjelbërimit rreth hapësirës së projektit. Si rezultat i procesit të dialogut u ndërmorën hapat e mëposhtëm për të adresuar këtë çështje:

- Në vitet 2016 dhe 2017, kompania mbolli 1,000 pemë Paulania në Marinëz dhe 2,000 rrënjë plepa në Sheqishte.
- Kompania e ka vazhduar çdo vit projektin e mbjelljes së pemëve, në bashkëpunim me pushtetin vendor.



Një anëtar i komunitetit dhe përfaqësues i kompanisë vizitojnë zonën brenda perimetrit të sigurisë, ku janë mbjellë 18,000 pemë në një sipërfaqe prej 10 hektarësh midis zonës së prodhimit dhe zonave të banuara (Foto nga: Felix Davey)

Rishikim i kontratave të Bankers me nënkontraktorët në lidhje me punësimin e banorëve vendas

Duke pasur parasysh shqetësimet e komunitetit lidhur me nivelin e ulët të punësimit të banorëve, Bankers përfshiu një klauzolë në kontratat e saj me nënkontraktorët që përcaktonte se "në kushte të barabarta, përparësi do t'u jepet vendasve në punësim".

Mbështetja për të adresuar çështjen e ujit në Marinëz

Ndërsa çështja e ujit në Marinëz u ngrit si pjesë e diskutimeve në tryezën të rrumbullakët, kjo çështje u negociua drejtpërdrejt ndërmjet kompanisë dhe pushtetit vendor. Gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve anëtarët e komunitetit janë informuar vazhdimisht për ecurinë e projektit për adresimin e çështjes së ujit në Marinëz. Projekti përfshinte:

- një Memorandum Mirëkuptimi midis kompanisë dhe Bashkisë Roskovec;
- një pus i ri, i cili u hap në vitin 2017, dorëzuar Bashkisë Roskovec;

- mbështetje teknike për Bashkinë Roskovec për të përgatitur një projekt dhe për të aplikuar për fonde për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë; dhe
- sigurimin e materialeve për Bashkisë për riparimin e linjës së ujësjellësit, e cila do të mundësonte furnizimin me ujë në disa pjesë të fshatit Marinëz.

Sigurimi i ngrohjes në shtatë shkolla

Megjithëse nuk ishte një çështje e ngritur për t'u trajtuar nga tryeza e dialogut, kompania siguroi ngrohje për shtatë shkolla gjatë muajve janar dhe shkurt 2016, në përgjigje të një kërkesë të bërë nga anëtarët e komunitetit gjatë një takimi të përbashkët. Kompania ofroi pajisje për ngrohje dhe lëndë djegëse sipas nevojës, si dru dhe naftë.

Rritje e transparencës në lidhje me taksat

Dy takime u organizuan në 2015 dhe 2017 për të diskutuar çështje që lidhen me transparencën e taksave të paguara nga Bankers, një çështje e ngritur në fillim të procesit, së bashku me çështjet e tjera. Në këto takime morën pjesë dhe përfaqësues nga Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI).

4) Marrëveshje për Dialogun Komunitet-Kompani

Pasi palët kishin përfunduar negociimin e çështjeve sipas grupeve të punës, vendosën t'i bashkonin grupet e punës për të formuar një platformë të zgjeruar të dialogut, Tryezën e Dialogut Komunitet-Kompani, përmes së cilës palët mund të vazhdonin të angazhoheshin për të diskutuar problemet pas largimit të CAO-s. Palët ranë dakord që tryeza e rumbullakët do të drejtohet bashkërisht nga përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanisë.

Në një takim të përbashkët në shkurt 2018, palët ranë dakord të miratojnë Rregullat Bazë të Tryezës së Dialogut Komunitet-Kompani.¹

¹ http://www.cao-ombudsman.org/cases/document-links/documents/Final_Guidelines_Community-CompanyRoundtable.pdf

Dokumenti përmbledh pika të interesit të përbashkët për angazhim të vazhdueshëm përmes platformës së zgjeruar të dialogut në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale të operacioneve të Bankers Petroleum në zonën e Patos-Marinzës.



Rregullat e miratuara bashkërisht nga përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanisë, Shkurt 2018

Në maj 2018, CAO organizoi një seancë trajnimit mbi lehtësimin për një grup prej katër anëtarësh të tryezës së dialogut, të cilët do të moderojnë takimet e ardhshme të tryezës së dialogut pas largimit të CAO-s. CAO ndoqi në rolin e vëzhguesit dy takime të tryezës së dialogut, në Maj dhe Shtator 2018 si pjesë e rolit të saj monitorues.



Një anëtar i komunitetit dhe i kompanisë drejtojnë tryezën e dialogut, Shtator 2018 (Foto: Felix Davey)

REFLEKTIME TË CAO-S NGA PROCESI

Rritja e kapaciteteve dhe përgatitja janë të rëndësishme në çdo fazë

Takimi i parë i përbashkët (Janar 2014) theksoi nevojën për një përgatitje më të mirë me palët para takimeve të përbashkëta, duke përfshirë dhe adresimin e çështjeve të përfaqësimit dhe rritjes së kapaciteteve dhe aftësive në komunikim dhe negociim.

Duke pasur parasysh zgjatjen në kohë të procesit, anëtarë të rinj nga komuniteti iu bashkuan procesit, ndërkohë që kisht të tjerë që u larguan. Të gjithë ata që iu bashkuan procesit më vonë, ndoqën trajnime për rritjen e kapaciteteve para se të merrnin pjesë në takimet e përbashkëta, duke i ndihmuar të përgatiteshin për një komunikim efektiv dhe për të kuptuar më mirë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Megjithëse disa anëtarë të komunitetit fillimisht kishin hezitime për t'u përfshirë në trajnim, më vonë e vlerësuan dobinë e aftësive të marra në adresimin e problemeve në komunikim dhe sfidave të tjera të hasura gjatë procesit të dialogut. Përveç rritjes së kapaciteteve, takimet bilaterale ofruan një qasje tjetër efektive për t'i përgatitur palët për një angazhim konstruktiv në takimet e përbashkëta.

Komunikimi dhe bashkëpunimi përmirësuan procesin e zgjidhjes së problemeve

Komunikimi dhe qasja bashkëpunuese e përdorur gjatë procesit i ndihmoi palët që të identifikonin dhe eksploronin me efektivitet çështjet mjedisore, sociale dhe të investimeve dhe të punonin së bashku për të gjetur mënyra për zgjidhjen e tyre.

“Jemi të kënaqur të ulemi e të diskutojmë ballë për ballë me drejtues të lartë të Bankers për të adresuar shqetësimet e komunitetit të Patos-Marinzës që lidhen me operacionet në fushën naftëmbajtëse. Një komunikim i tillë ka munguar për kohë të gjatë”.

Reflektim nga një anëtar i komunitetit nga Zharrëza shprehur për grupin e CAO-s në fazën fillestare të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Fleksibiliteti i procesit ndihmoi në adresimin e nevojave emergjente

Procesi u ofroi palëve mundësinë për të qenë fleksibël dhe për ta përshtatur axhendën me shqetësimet e tyre më të ngutshme. Për shembull, në prill 2015, tryeza e dialogut vendosi të ndryshojë agjendën e rënë dakord më parë, për të diskutuar për impaket e shpërthimit të pusit në Marinëz. Mundësia për të qenë fleksibël u mundësia nga zhvillimi i një platforme të mirëstrukturuar të dialogut, përmes së cilës palët krijuan besim te njëra-tjetra dhe te procesi.

Faktorët e jashtëm mund të ndikojnë te procesi

- **Transferimi i pronësisë së kompanisë.** Në mars 2016, Bankers informoi CAO-n se kishin lidhur një marrëveshje për t'u blerë nga një kompani e Korporatës Geo-Jade Petroleum. Megjithëse kompania e re e kishte paguar tërësisht huanë tek IFC-ja, ata konfirmuan gatishmërinë e tyre për të vazhduar procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Megjithatë, procesi u pezullua për disa muaj deri sa u mor konfirmimi nga strukturat drejtuese. Kjo bëri që të binte interesi i palëve për procesin.
- **Ndikimi i situatës së tregut.** Një prej çështjeve më të ngutshme sociale ishte shkalla e ulët e punësimit të banorëve nga kompania dhe nënkontraktorët e saj. Rënia e çmimit të naftës në vitin 2014 reduktoi operacionet e kompanisë dhe rrjedhimisht mundësitë për punësim dhe investime. Kjo ndikoi negativisht në kontekstin në të cilin po zhvillohej dialogu.
- **Roli i aktorëve të jashtëm në proces.** Bazuar në çështje specifike që palët ranë dakord për të adresuar përmes procesit, përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanisë e konsideruan të nevojshme të ftonin përfaqësues dhe ekspertë nga institucione shtetërore në nivel qendror (MIE, IGJEU, Instituti i Shëndetit Rajonal), nga pushteti

vendor, si dhe nga institucione të tjera të specializuara (si EITI dhe Albpetrol), për të ndihmuar në adresimin e çështjeve të caktuara.

- **Formalitetet e institucioneve shtetërore mund ta vonojnë procesin.** Duke marrë parasysh se çështja kryesore e ngritur në ankesë (shkaku i tërmeteve) kërkonte angazhimin e autoriteteve shtetërore, ka pasur një sërë vonesash si rezultat i nevojës për të punuar me më shumë palë të interesit të cilat duhet të ndiqnin procedura të caktuara për t'u përfshirë në proces.

Dinamikat e brendshme brenda grupit të dialogut duhet të adresohen.

CAO mori parasysh pengesat për një angazhim efektiv që lidheshin me procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe punoi me palët për t'i kapërcyer ato.

- Gjatë procesit, disa anëtarë të tryezës së dialogut u larguan dhe të tjerë iu bashkuan procesit nga të dyja palët. Qëndrueshmëria e përfaqësimit të komunitetit dhe ndryshimi i dinamikës së anëtarësisë së tryezës e ngadalësoi procesin.
- Informimi dhe konsultimi me komunitetin ishin një pjesë e rëndësishme, por dhe një sfidë e procesit, veçanërisht procesi i konsultimit midis përfaqësuesve të komunitetit dhe anëtarëve të tjerë në komunitet në lidhje me procesin e dialogut.
- Pezullimi i procesit të dialogut ka pasur një ndikim negativ në proces dhe në qëndrueshmërinë e pjesëmarrjes, veçanërisht në pjesëmarrjen e anëtarëve të komunitetit.

PËRFUNDIMI I PROCESIT TË ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

CAO po e përfundon përfshirjen e saj në këtë rast, duke qenë se:

- Palët kanë rënë dakord që çështja kryesore e ngritur në ankesë (shkaqet e tërmeteve në zonën e Patos-Marinzës) të adresohet përmes procesit që po drejtohet nga qeveria; dhe
- Palët kanë rënë dakord që çështjet sociale dhe të investimeve, për të cilat ata vendosën t'i trajtonin përmes procesit, janë diskutuar dhe zgjidhur sipas dakortësisë së të dyja palëve.

Duke e konsideruar me vlerë vazhdimin e bashkëpunimit me njëra-tjetrën, palët kanë rënë dakord që të takohen çdo tre muaj përmes Tryezës së Dialogut Komunitet-Kompani edhe pas përfundimit të procesit të dialogut të lehtësuar nga CAO. Tryeza do të funksionojnë në bazë të rregullave të rena dakord nga të dyja palët, të cilat u përgatitën me ndihmën e CAO-s dhe u miratuan nga grupi i dialogut në takimin e përbashkët të mbajtur në Shkurt 2018.